



REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA ADMINISTRATIVE E SHKALLES SE PARE
KORÇE

Nr. 198 Regj. Them
Data e Regj: 07.01.2015

Nr.200 Vendimi
Data:21.04.2015

V E N D I M

NE EMER TE REPUBLIKES

Gjykata Administrative e Shkalles se Pare Korce e perbere nga:

SOKOL IBI - Gjyqtar

Asistuar prej sekretares Marinela Rushi, pasi shqyrtoi ne seance gjyqesore publike, sot me date 21.04.2015, çeshtjen administrative me Nr.198 Regj.Them, qe perket paleve ndergjyqese:

PADITES: Drejtoria e Sherbimit Spitalor Kolonja, e perfaqesuar ne gjykim me autorizim nga Eridi Sherifi dhe Elvira Tafili.

PADITUR: Drejtoria Rajonale Tatimore Korçe, e perfaqesuar ne gjykim me autorizim nga Mirela Veriga.

OBJEKTI: Anulimin e njoftim vleresimit tatimor me Nr.26205 Prot. datë 30.10.2014 si dhe njoftim vleresimit tatimor Nr.12296, date 08.07.2014.

BAZA LIGJORE: Neni 31, 153-156 e vijues te K.Pr.Civile, Ligji Nr.49/2012, Ligji Nr.8560/1999 "Per Procedurat Tatimore".

Ne perfundim te gjykimit, gjykata pasi shqyrtoi provat ne teresi, qe e konfirmojne perfundimtare te pales paditese e cila perfundimisht kerkoi pranimiten e palise, pala e paditur perfundimisht kerkoi rrezimin e padise.

VEREN

Se pala paditese ka paraqitur para kesaj gjykate kerkesepadine me objektin e mesiperm.

Gjate gjykimit rezultoi e provuar se nepermjet njoftim vleresimit tatimor Nr.12296, date 08.07.2014 dhe Nr.20205, date 30.10.2014 pala e paditur i njofton paditesit gjoben ne shumen 110.000 leke, dhe gjoben ne shumen 20.000 leke per kryerjen e kundravajtjes administrative te mosdeklarimit te TVSH-se (tatimit per vieren e shtuar) ne kohen e duhur per periudhen kohore qershor 2013-qershor 2014.

Paditesi duke mos qene dakord me keto njoftim vleresime tatimore i kundershton ato ne Drejtorine e Apelimit Tatimor.

Drejtoria e Apelimit Tatimor me vendimin Nr.32445/1, date 06.01.2015 ka vendosur te refuzoje ankimin kunder njoftim vleresimit tatimor Nr.20205, date 30.10.2014 pasi ka kaluar afati i ankimit.

Drejtoria e Apelimit Tatimor me vendimin Nr.21940 Prot, date 04.12.2014 ka vendosur lenien ne fuqi te njoftim vleresimit tatimor Nr.12296, date 08.07.2014.

Ne te tilla rrethana pala paditese i eshte drejtuar me padine objekt gjykimi gjykates duke pretenduar se pari se e ka paraqitur ankimin brenda afatit ligjor ne Drejtorine e Apelimit Tatimor.

Rezulton se pala paditese e ka paraqitur ankimin e saj ne Drejtorine e Apelimit Tatimor me poste (kunder njoftim vleresimit tatimor Nr.20205, date 30.10.2014) ne daten 12.12.2014, ndersa nuk rezulton e provuar data e sakte se kur pala paditese ka marre dijeni per aktin administrativ njoftim vleresimi per detyrimet tatimore Nr.20205, date 30.10.2014. Ne te tilla rrethana gjykata cmon se pala paditese e ka paraqitur ankimin e saj ne Drejtorine e Apelimit Tatimor kunder ketij akti administrativ njoftim vleresimi per detyrimet tatimore, brenda afatit 30 ditor nga dita e marrjes dijeni per kete akt administrativ dhe ne te tilla rrethana Drejtoria e Apelimit Tatimor ishte e detyruar ta shqyrtonte kete ankim dhe te shprehej me vendim lidhur me te dhe jo te vendoste refuzimin e ankimit.

Ne te tilla rrethana paditesi legjitimohet ti drejtohet me kete padi kesaj gjykate.

Gjate gjykimit paditesi pretendoi se nuk eshte i detyruar te paguaj TVSH per furnizimet me mallra dhe sherbime shendetesore qe kryhen, sepse qe nga data 01.04.2014 nuk eshte me subjekt i TVSH-se ne baze te ligjit Nr.182/2013 "Per disa shtesa dhe ndryshime ne ligjin Nr.7928/1995 "Per TVSH-ne".

Gjate gjykimit pala paditese pretendoi se pala e paditur nuk na ka informuar per detyrimin tone per te deklaruar TVSH-ne edhe kur detyrimin e kemi zero si dhe nuk na ka informuar per gjobat qe ka vendosur periodikisht gjate kesaj periudhe kohore ne shumen 10.000 leke per cdo mosdeklarim periodik te TVSH-se.

Pala e paditur ka prapesuar duke pretenduar se paditesi nuk ka deklaruar TVSH-ne per periudhen kohore te siperpermendur dhe ne zbatim te nenit 113 te ligjit nr.9920/2008 "Per Procedurat Tatimore" gjobitet ne masen e 10.000 lekeve per cdo mosdeklarim.

Pala e paditur ka prapesuar duke pretenduar se paditesi kishte detyrimin ligjor te deklaronte edhe per periudhen kur detyrimi i tij per TVSH-ne ka qene ne masen zero, dhe ne te tilla rrethana duhet te dorezonte deklaraten tatimore me TVSH ne masen zero, gje te cilen nuk e ka kryer paditesi. Ky detyrim sipas pales se paditur i buron paditesit edhe sipas udhezimit nr.24, date 02.09.2008 te Ministririt te Financave.

Ne nenin 113 te ligjit Nr.9920, date 19.05.2008 "Per Procedurat Tatimore ne R.Shqiperise" thuhet: "*Tatimpaguesi, i cili nuk dorëzon deklaratën tatimore në afat, dënohet me gjobë me 10 000 lekë për çdo deklaratë tatimore të padorëzuar*".

Ne nenin 10/1 te ligjit Nr.9920, date 19.05.2008 "Per Procedurat Tatimore ne R.Shqiperise" thuhet: "*Ministri i Financave nxjerr udhëzim të përgjithshëm në zbatim të këtij ligji*".

Ne piken Nr.65.1.2 te udhezimit te Ministririt te Financave Nr.24, date 02.09.2008 "Per Procedurat tatimore e Republikën e Shqiperise" i ndryshuar thuhet: "*Personi i tatueshëm paraqet deklaratat tatimore te çdo tatimi dhe te kontributeve te sigurimeve shoqërore e shëndetësore edhe në qoftë se ai, për periudhën tatimore nuk ka për të paguar detyrim tatimor apo kontribute, pasi detyrimi i tij mund te jete zero ose pasi ai mund te mos kete kryer aktivitet gjate asaj periudhe tatimore. Plotësimi i saktë i deklaratës, paraqitja dhe pagesa brenda*

afateve kohore të përcaktuara është detyrim ligjor për të gjithë personat e tatueshëm. Moszbatimi i këtij detyrimi ngarkon me përgjegjësi ligjore personin e tatueshëm dhe dënohet në bazë të ligjit dhe të këtij udhëzimi”.

Ne te tilla rrethana ne baze te pikes 65.1.2 te udhezimit te Ministrit te Financave Nr.24, date 02.09.2008 “Per Procedurat tatimore e Republikën e Shqiperise” i ndryshuar, pala paditese kishte detyrimin qe te deklaronte TVSH-ne prane pales se paditur me vlere zero edhe ne kushtet kur ai nuk kishte detyrimin per te paguar TVSH.

Mosdeklarimi i TVSH-se nga pala paditese per periudhen kohore te siperpermendur, perben kundravajtje administrative te kryer nga pala paditese dhe ne te tilla rrethana me te drejte pala e paditur e ka konstatuar te kryer kete kundravajtje administrative nga paditesi dhe ne baze te nenit 113 te ligjit Nr.9920, date 19.05.2008 “Per Procedurat tatimore ne R.Shqiperise” e ka denuar palen paditese ne masen e 110.000 lekeve dhe 20.000 lekeve per kete kundravajtje administrative (10.000 leke per çdo rast te kryerjes se kesaj kundravajtje administrative).

Ne te tilla rrethana pretendimet e paditesit ne padi jane te pabazuara ne ligj dhe ne prova dhe per keto arsye padia e paditesit duhet rrezuar nga gjykata.

Ne baze te nenit 45 te ligjit Nr. 49, date 03.05.2012 “Per Organizimin dhe Funksonimin e Gjykatave Administrative dhe Gjykimin e Mosmarrveshjeve Administrative”, ndaj ketij vendimi nuk lejohet ankim, sepse objekt kerkimi eshte kundershtimi i akteve administrative qe permbajne detyrime ne te holla me vlere me te vogel se njezetefishi i pages minimale ne shkalle vendi. Paga minimale ne shkalle vendi me baze te V.K.M Nr.573, date 03.07.2013 eshte ne masen 22.000 leke, ndersa njezetefishi i saj eshte i barabarte me 440.000 leke.

PER KETO ARSYE

Gjykata ne baze te neneve 40, 41, 45 te ligjit Nr. 49, date 03.05.2012 “Per Organizimin dhe Funksonimin e Gjykatave Administrative dhe Gjykimin e Mosmarrveshjeve Administrative”

VENDOSI


1. Rrezimin e padise si te pabazuar ne prova dhe ne ligj.
2. Shpenzimet gjyqesore jane ne ngarkim te pales paditese.

76

- Kunder ketij vendimi nuk lejoht ankim.
- U shpall sot me date 21.04.2015 ne Korçe.


SEKRETARE

MARINELA RUSHI



GJYQITAR

SOKOL IBI



Shpenzimet gjyqesore:

1. Takse pulle 3.000 leke;
Totali 3.000 leke (te parapaguara nga paditesi).

Shenim: Vendimi ka marre forme te prere sot ne daten _____

**KANCELAR
ALEKSANDER DINO**

